



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.245/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.N “3L ING” BI me nr. unik identifikues 810887814, me seli në Prishtinë, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga B.M., avokat nga Gjakova, kundër debitorit NNP “S.P.” B.I, me nr. unik identifikues 811151498, me seli në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat J.O. nga Prishtina,, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.760/22 të datës 30.06.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.P.N “3L ING” BI, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 760/22 të datës 30.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 760/22 të datës 30.06.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të NNP “S.P.” B.I, kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.60/2021 të dt. 01.02.2021 të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim është Anuluar, si dhe ne II Obligohet kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën prej 104.00 (njëqind e katër) euro, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimi të gabuar të së drejtës procedurale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 760/22 të datës 30.06.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar debitori me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit dhe të vërtetohet vendimi i shkallës së parë KPPP.nr. 760/22 të datës 30.06.2023

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.N “3L ING” BI., me datën 01.02.2021 ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm të faturës nr. 1/2020 të datës 07.12.2020 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t’ia paguajë shumën prej 3,000.00 €, me kamatë vonesë ligjore vjetore prej 8% nga dita e parashtrimit të propozimit e deri në pagesën përfundimtare si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore me vendim të formës së prerë si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr. 60/2021 të dt. 01.02.2021 e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 60/21 të datës 01.02.2021 duke theksuar se urdhri përmbartimor është i papërshtatshëm nuk i përmban të gjitha të dhënat e parapara me nenin 40 par.3 të LPP-së dhe në kuptim të nenit 42 par. par.2 nuk i përmban të dhënat e përcaktuara me par.1 të këtij neni nuk ka cilësinë as efektin e urdhrit përmbartimor dhe meqë nuk ka efekt juridik duhet të shpallet nul dhe të shfuqizohet. Ka shtuar se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë që dëshmon dorëzimin e këtyre faturave tek debitori e që ky është kusht elementar që të mund të iniciohet procedurë

përmbare, pasi që në flet kthim dhe dëftesën për pranimin e dërgesës të dorëzuara shkruan vetëm “Dokument” e nga kjo nuk mund të thuhet se është dorëzuar fatura e cila është e panëshkruar nga debitori dhe pa vulën e firmës. Me kërkesë që të aprohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbare i lëshuar nga Përmbaresi Privat. Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se propozimi për përmbare është lëshuar në bazë të dokumentit të besueshëm, fatura është origjinal ndërsa me flet kthesën e datës 08.12.2020 vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën Nr.1.2020 të datës 07.12.2020, bashkë me vërtetimin e postës R-9776853 të datës 08.12.2020. Me kërkesë që të refuzohet Prapësimi i debitorit dhe Urdhri Përmbare P.nr. 60/21 të datës 01.02.2020 të mbetet në fuqi.

Gjykata, Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen e kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbare po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbare. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura me Nr. 1/2020 të datës 07.12.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbare, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbare paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura nr. 1/2020 e datës 07.12.2020, në bazë të së cilës është lejuar përmbaremi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohej se fatura është dorëzuar me rregull dhe është pranuar nga ana e debitorit së bashku me

detyrimin që rrjedh nga kjo faturë. Rrjedhimisht Gjykata vlerëson se subjekti N.N.P S.P. nuk mund të ketë cilësinë e debitorit sipas nenit 29.3 të LPP-së në këtë procedurë përbarimore dhe të obligohet në pagimin e detyrimit që rrjedh nga fatura nr. 1/2020 e datës 07.12.2020 përderisa fatura rezulton të jetë lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë i vlerëson pretendimet e kreditorit se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përbarimi është pranuar nga ana e debitorit përmes nënshkrimit të flete-kthesës së Postës së Kosovës të datës 08.12.2020 por pretendimin në fjalë e vlerësoj si të pabazuar kjo për faktin se nga flete-kthesa e Postës së Kosovës pjesë e shkresave të lëndës, nuk mund të vërtetohet se cili lloj i dokumentit është dërguar nga kreditori tek debitori, kjo sepse tek lloji i dërgesës evidentohet përshkrimi “Dokument” por jo edhe fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përbarimi, andaj Gjykata nuk mund ta konsideroj si të rregullt pranimin e faturës nr. 1/2020 të datës 07.12.2020 nga ana e debitorit përderisa nuk ka prova përmes të cilave vërtetohet se debitori është shërbyer me faturën e lartcekur, dhe se të njëjtën e ka pranuar duke mos kundërshtuar detyrimin që rrjedh nga kjo faturë. Si dhe shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 453 dhe 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 € siç është e përcaktuar me Rregulloren për tarifatat e avokatëve e datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përbarim ia ka bashkangjitur faturën me nr.1/2020 e datës 07.12.2020, e cila nuk është e nënshkruar e as pranuar nga debitori, në rastin konkret faturat nuk paraqesin dokument të besueshëm pasi që nuk janë plotësuar kushtet nga neni 27 i LPP-së.

Tutje, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e

të njëjtat nuk janë nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se fatura si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.245/24, me datë 16.04.2024

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**